



# **STRATEGJIA LOKALE PËR TË RINJTË**

**TË KOMUNËS SË GOSTIVARIT**

**2024 – 2028**



**Strategjia lokale  
për të rinjtë  
të Komunës së Gostivarit**

**për periudhën  
e viteve 2024-2028**



# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>5</b>
<b>PROFILI I KOMUNËS</b> .....	<b>7</b>
<b>1. ANALIZA E GJENDJES</b> .....	<b>9</b>
<b>2. KORNIZA STRATEGJIKE</b> .....	<b>16</b>
<b>3. MENAXHIMI I RREZIQEVE</b> .....	<b>29</b>
<b>4. MONITORIM DHE EVALUIM I STRATEGJISË</b> .....	<b>30</b>
<b>5. KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN</b> .....	<b>31</b>

## **TITULLI I PUBLIKIMIT**

Strategjisë së të rinjëve të Komunës së Gostivarit për periudhën e viteve 2024–2028

## **BOTUES**

Komuna e Gostivarit

## **PËR BOTUESIN**

Dr. Arben Taravari, Kryetari

## **TIRAZHI**

50 kopje

## **DIZAJNI**

Brigada dizajn



Projekti i financuar nga  
Bashkimi Evropian

Ky publikim është përgatitur me ndihmë financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



## KOMUNA E GOSTIVARIT



### KRYETARIT



**Dr. Arben Taravari**

[arben.taravari@gostivari.gov.mk](mailto:arben.taravari@gostivari.gov.mk)

Bul. "Vëllezërit Gjinoski" 61  
1230, Gostivar  
[info@gostivari.gov.mk](mailto:info@gostivari.gov.mk)  
tel. +389 (0) 42 213 511  
fax +389 (0) 42 214 406

[www.gostivari.gov.mk](http://www.gostivari.gov.mk)



## LISTA E SHKURTESAVE

<b>APRMV</b>	Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut
<b>LPRPR</b>	Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjëve dhe Politikat Rinore
<b>KRL</b>	Këshilli Rinor Lokal
<b>KLP</b>	Këshilli Lokal për Parandalimin
<b>QR</b>	Qendra Rinore
<b>SHMK</b>	Shkolla e mesme komunale
<b>QPS</b>	Qendra për punë sociale



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**K**omuna e Gostivarit në bashkëpunim me Koalicionin e organizatave rinore “Sega” zbatoi proces të krijimit të Strategjisë së të rinjëve të Komunës së Gostivarit për periudhën e viteve 2024–2028, në përputhje me Ligjin për pjesëmarrjen e të rinjëve dhe politikat rinore (LPRPR). Përgatitja e kësaj strategjie mbështetet në kuadër të projektit “Pjesëmarrja e të rinjëve për zhvillim të fortë dhe të qëndrueshëm të bashkësisë”, të financuar nga Komunëmi Evropian. Projekti zbatohet nga Koalicioni i organizatave rinore “Sega” në partneritet me SOS Fshatin e fëmijëve, Qendrën e vullnetarëve Shkup dhe Forumin e grave Tetovë. Komuna e Gostivarit u zgjodh një nga katër komunat ku do të mbështetet krijimi i strategjive për të rinjtë, së bashku me Komunën e Manastirit, Komunën e Karposhit dhe Komunën e Kisella Vodës. Gjatë procesit të krijimit të strategjisë, mbështetjen profesionale e siguroi kompania konsulente “Sisteme strategjike të menaxhmentit”.

Aktiviteti i parë i zbatuar ishte hulumtimi i mendimit publik, i zbatuar paralelisht në të katër komunat. Hulumtimi në territorin e Komunës së Gostivarit është zbatuar në periudhën e muajit tetor të vitit 2022. Në përputhje me raportin që rezulton nga hulumtimi i zbatuar, janë anketuar gjithsej 206 të anketuar, të rinj të moshës nga 15–29 vjeç nga Komuna e Gostivarit.

Paralelisht me këtë aktivitet, me qëllim që fitohet pasqyrë më gjithëpërfshirëse e kushteve e të rinjëve, nevojave dhe sfidave të tyre përmes prizmit të vetëqeverisjes lokale, u zbatuan 2 (dy) intervista individuale, prej të cilave njëra me Udhëheqësin e Sektorit të arsimit të Komunës së Gostivarit dhe një me Udhëheqësin e Qendrës rinore, USS Gostivar.

Përveç kësaj, si aktiviteti i tretë i kësaj faze, u zbatua një fokus grup me 14 persona të rinj, duke përfshirë 4 shkollarë, 4 studentë, 2 përfaqësues të rinisë partiake dhe 4 përfaqësues të organizatave rinore qytetare. Qëllimi i këtij fokus grupi ishte definimi i problemeve me të cilat përballen të rinjtë në bashkësitë e tyre lokale, përzgjedhja e prioritetëve dhe theksimi i propozim zgjidhjeve të realizueshme.

Pas zbatimit të hapave të lartpërmendura metodologjike, nën udhëheqjen e personave të caktuar përgjegjës nga vetëqeverisja lokale, u organizuan punëtori nga grupi lokal i punës për krijimin e Strategjisë së të rinjëve të Komunës së Gostivarit, e përbërë nga përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, administratës lokale, një përfaqësues i Agjencisë së punësimit, një përfaqësues i Kryqit të Kuq të Gostivarit, përfaqësues të shkollave fillore dhe të mesme, përfaqësues të organizatave rinore lokale, shkollarë si dhe rinia politike.

Grupi lokal i punës mbajti gjithsej 4 punëtori në periudhën nga tetori deri në fund të nëntorit të vitit 2022. Mes tjerash, me qëllim që t'i qaset në mënyrë strukturore vargut të çështjeve të ndryshme që lidhen me të drejtat e të rinjëve në procesin e përgatitjes së strategjisë, grupi i punës bëri të ditur ndërhyrjet e propozuara të ndahen dhe reflektohen tetë prioritetet kombëtare për të rinjtë edhe atë:



- 1. Pjesëmarrja e të rinjëve**
- 2. Informimi i të rinjëve**
- 3. Punë për të rinjtë**
- 4. Arsimi**
- 5. Kultura dhe sporti**
- 6. Shëndeti**
- 7. Sipërmarrësia dhe mbështetja gjatë punësimit**
- 8. Siguria**

Gjendja e të rinjëve në Komunën e Gostivarit tregon nevojë të theksuar për arsim të përmirësuar, rritje të sigurisë dhe përmirësim të sigurisë shëndetësore. Grupe të ndryshme etnike kanë prioritete të ndryshme, por përmirësimi i arsimit është një domosdoshmëri universale. Analiza e faktorëve politikë, ekonomikë, socialë, teknologjikë, legjislativë dhe ekologjikë zbulon një kontekst kompleks që duhet të përfshihet në strategjinë e të rinjëve. Palët e interesuara përfshijnë institucione dhe organizata të ndryshme, bashkëpunimi dhe mbështetja e të cilave janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të strategjisë. Analiza SWOT identifikon anët e forta dhe të dobëta, mundësitë dhe kërcënimet, gjë që ndihmon në formimin e strategjisë që do të forcojë kapacitetet dhe do të zvogëlojë rreziqet për të rinjtë në Komunën e Gostivarit. Në përfundim, mund të thuhet se mbështetja dhe pjesëmarrja aktive e të rinjëve janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të strategjisë dhe krijimin e një mjedisi pozitiv për zhvillimin e tyre.

Strategjia për të rinjtë për Komunën e Gostivarit 2024–2028 adreson nevojat e përcaktuara përmes analizave të zbatuara dhe vendosë qëllimin kryesor, qëllimet specifike, rezultatet dhe masat për secilin nga tetë prioritetet. Fokusi i strategjisë është pjesëmarrja proaktive e të rinjëve në politikëbërje, vendimmarrje, rretëzim dhe inkluzion në Komunën e Gostivarit, me qëllim të sigurimit të kushteve për jetë cilësore, punë, rritje dhe zhvillim personal dhe informim dhe bashkëpunim strategjik.

Përveç kësaj, plani i veprimit 2024–2025 përmban aktivitete konkrete për arritjen e qëllimeve të strategjisë. Bartësi kryesor i strategjisë do të jetë Këshilli Rinor Lokal i Komunës së Gostivarit. Këshilli Rinor Lokal i Komunës së Gostivarit do të jetë gjithashtu përgjegjës për vlerësimin e planit të zbatuar të veprimit të viteve 2024–2025 dhe krijimin e planeve të reja të veprimit për vitet e ardhshme.

Strategjia lokale për të rinjtë të Komunës së Gostivarit 2024–2028 vendosë parimet dhe udhëzimet themelore për veprimin e të gjithë faktorëve në shoqëri që do të çojnë drejt përmirësimit të gjendjes socio-ekonomike e të rinjëve dhe në krijimin e një mjedisi që do t'u mundësojë të rinjëve t'i realizojnë të drejtat, nevojat dhe interesat e tyre.





## PROFILI I KOMUNËS

**G**ostivari ka një histori të gjatë, ndërsa për lindjen e qytetit ka shumë legjenda me versione të ndryshme. Ekzistenca e qytetit dëshkohet nga dokumente që datojnë nga periudha antike e deri në Mesjetë. Me kalimin e kohës, arriti të mbijetojë dhe në fund të shekullit të 19-të, gjatë Perandorisë Osmane, arriti të rritet në një qendër rajonale, funksion që e ka edhe sot.

Komuna e Gostivarit ndodhet në rajonin veriperëndimor të Maqedonisë së Veriut dhe sipas regjistrimit të vitit 2021 ka popullsi prej rreth 60.000 banorë. Qyteti është i njohur për historinë e tij të pasur, trashëgiminë kulturore dhe bukurinë piktoreske, duke e bërë atë destinacion të popullarizuar turistik. Ekonomia lokale bazohet kryesisht në industri, me fokus në tekstilin, përpunimin e metaleve dhe prodhimin e ushqimit. Vitet e fundit, komuna ka bërë investime të rëndësishme në infrastrukturë dhe shërbime publike, duke përfshirë ndërtimin e rrugëve të reja, shkollave dhe objekteve shëndetësore. Gjithashtu, ka interesim në rritje për eko-turizmin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, me ç'rast disa projekte në zhvillim për të promovuar bukurinë natyrore dhe trashëgiminë kulturore të rajonit. Në përgjithësi, Komuna e Gostivarit është një komunitet dinamik dhe në rritje që është i angazhuar për të promovuar rritjen ekonomike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj.

Karakteristikat e komunës, vendndodhja e saj në territorin e Fushës së Gostivarit dhe burimet natyrore i japin qytetit të Gostivarit mundësinë për të zgjeruar territorin e tij, duke mos rrezikuar potencialin rural të fshatrave përreth, por edhe burimet natyrore. Njëherësh, vetë vendndodhja lejon që qyteti të përparojë si qendër e madhe administrative, politike, ekonomike dhe kulturore në pjesën e sipërme të luginës së Pollogut. Si vlerë shtesë është numri i madh i mërgimtarëve që janë me punë të përkohshme në qytetet e Evropës Perëndimore dhe që, si grup qëllimor, përfaqësojnë një nga investitorët dhe drejtuesit më të mëdhenj të sektorit privat në komunë që është vazhdimisht në rritje.

### Vetëqeverisja lokale

Në kuadër të Vetëqeverisjes Lokale, në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale, ekzistojnë 2 (dy) organe edhe atë: Kryetari i Komunës së Gostivarit dhe Këshilli i Komunës.<sup>1</sup>

### Kryetari i komunës

**Dr. Arben Taravari**, në postin e Kryetarit të Komunës së Gostivarit erdhi më 02.11. të vitit 2017, pas fitores në zgjedhjet lokale më 29.10. të vitit 2017.


### Këshilli Komunal

Në Këshillin Komunal marrin pjesë 31 këshilltarë nga parti të ndryshme politike. Më 26 nëntor të vitit 2021, Valbon Limani u emërua Kryetar i Këshillit të Komunës së Gostivarit me shumicë votash. **Kompetencat e Këshillit** rregullohen nga Statuti i Komunës, si dhe nga **Rregullorja e Punës së Këshillit**.

<sup>1</sup> Statuti i Komunës së Gostivarit, <http://www.gostivari.gov.mk/web/index.php/mk/statuti-i-komunes>



## Organogrami – Shtrirja organizative e Komunës së Gostivarit





## 1. ANALIZA E GJENDJES

**N**ë këtë analizë, paraqitet në mënyrë të detajuar gjendja e të rinjëve në Komunën e Gostivarit nevojat dhe karakteristikat e tyre, ndërsa baza e analizës është hulumtimi gjithëpërfshirës në kuadër të të cilit janë zbatuar anketat, intervistat dhe fokus grupet.

### 1.1. ANALIZA E NEVOJAVE TË TË RINJËVE

#### 1. Arsimi

Të rinjtë në Gostivar shprehin nevojën për arsim cilësor dhe opsione të ndryshme arsimore. Është e rëndësishme të sigurohet qasje në arsim për të gjithë, duke përfshirë të rinjtë që mund të jenë në pozitë të pafavorshme socio-ekonomike. Në analizën, janë zbuluar mangësi në sistemin ekzistues arsimor, duke përfshirë përfshirjen e pamjaftueshme të teknologjive të reja dhe nevojën e theksuar për përmirësimin e programeve për ngritjen e cilësisë së arsimit.

#### 2. Shëndeti dhe siguria

Të rinjtë shprehin shqetësim për shëndetin dhe sigurinë e tyre. Kërkohen programe dhe iniciativa për të forcuar vetëdijen e të rinjëve për nevojat shëndetësore dhe parandalimin e problemeve shëndetësore. Të rinjtë kanë vetëdije të ulët për aspekte shëndetësore si ushqimi, aktiviteti fizik dhe shëndeti mental. Kërkohen fushatat dhe aktivitetet arsimore që do të ngritin vetëdijen tek të rinjtë për rëndësinë e jetës së shëndetshme.

#### 3. Sipërmarrësia

Të rinjtë kanë një interes të rëndësishëm për sipërmarrësi dhe biznes personal. Por, pengesat si vështirësitë financiare dhe mungesa e mbështetjes po i pengojnë ata. Është e nevojshme të krijohen programe dhe vegla për mbështetje financiare me qëllim të zhvillimit të mundësive për sipërmarrësi për të rinjtë. Përveç mbështetjes financiare, është e rëndësishme të theksohet edhe mbështetja mentoruese, ku duhet të krijohet një urë lidhëse midis mentorëve profesionistë dhe të rinjëve, e gjithashtu edhe sipërmarrësve të suksesshëm dhe të rinjëve. Shkëmbimi i përvojave ka një rol të madh për sipërmarrësit e rinj, dhe kjo është dëshmuar në të gjithë botën. Duhet të implementohen programet e trajnimit dhe mbështetjes së sipërmarrësve të rinj. Gjithashtu, siguroni rrugë të lehta për qasje në ndihmë financiare dhe grante për të filluar bizneset tuaja.

#### 4. Shëndeti mental

Të rinjtë shprehin nevojën për ndihmë në fushën e shëndetit mental. Një numër i konsiderueshëm shprehin simptoma të depresionit dhe stresit, por nuk kërkojnë ndihmë për të njëjtat. Ekziston nevoja për të ngritur vetëdijen dhe për të krijuar shërbime të arritshme ndihmëse. Të rinjtë duhet të edukohen për rëndësinë e shëndetit mental dhe t'u sigurohen shërbime të arritshme për konsultime dhe terapi.



## **1.2. PROFILI I TË RINJËVE NË KOMUNË**

### **1. Përkatësia etnike**

Në Gostivar, të rinjtë përbëhen nga grupe të ndryshme etnike si shqiptarë, maqedonas, turq, romë, etj. Secili grup ka nevojat e veta kulturore, sociale dhe ekonomike. Edhe pse me prejardhje të ndryshme, Gostivari është një qytet që njihet për bashkëpunimin ndërkulturor dhe bashkëjetesën shumë të mirë midis kategorive dhe përkatësive të ndryshme. Për të mbështetur grupe të ndryshme etnike, është e nevojshme të krijohen programe për integrimin ndërkulturor arsimor dhe aktivitete që përmirësojnë marrëdhëniet ndëretnike.

### **2. Arsimi dhe profesioni**

Të rinjtë kanë nivele të ndryshme arsimore dhe qëllime të ndryshme në karrierë. Megjithatë, më i konsiderueshëm është interesi për sipërmarrësinë dhe zhvillimin profesional. Është evidente nevoja për të krijuar programe për avancim në karrierë dhe praktikim në mënyrë që të lehtësohet vendosja e të rinjëve në botën e punës.

### **3. Karakteristikat socio-ekonomike**

Të rinjtë kanë karakteristika të ndryshme socio-ekonomike, duke përfshirë faktorë të tillë si statusi familjar, të ardhurat dhe jetesa. Është e nevojshme të krijohen programe për inkluzion socio-ekonomik dhe mbështetjen financiare për të rinjtë të cilët janë në vështirësi socio-ekonomike dhe të rinjtë nga kategoritë e rrezikuara.

### **4. Qendrat rinore**

Në komunën e Gostivarit janë aktive 3 qendra rinore, si më poshtë:

1. Qendra Rinore e Resurseve ICAN
2. Qendra për të rinjtë dhe bashkësinë
3. CoWork

Të gjitha këto qendra punojnë me të rinjtë në programe dhe mbështetje të ndryshme, duke filluar nga aftësitë e buta, sipërmarrësi, gjuhët, kultura, sporti, pjesëmarrja e të rinjëve dhe aktivitete të tjera të ndryshme. Vizita në këto qendra rinore për vitin 2023 është mbi 8.000 vizita, numër ky që është i kënaqshëm për Komunën e Gostivarit.



### **1.3. ANALIZA E FAKTORËVE POLITIK, EKONOMIK, SOCIAL, JURIDIK, TEKNOLOGJIK DHE EKOLOGJIK**

Grupi i punës zbatoi analizë të faktorëve në mjedisin që kanë ndikim të veçantë tek të rinjtë. U analizuan faktorët politikë, ekonomikë, socialë, teknologjikë, legjislativë dhe ekologjikë dhe u veçuan një varg aspektesh që kanë ndikim pozitiv ose negativ në zhvillimin e të rinjëve. Detajet e kësaj analize janë paraqitur sipas fushave.

#### **Aspektet politike**

**Zgjedhjet parlamentare dhe lokale:** Zgjedhjet rregullta, si parlamentare dhe lokale, krijojnë një kontekst për formimin e agjendave dhe strategjive politike në nivel lokal përmes të cilave mund të sigurohet mbështetja e të rinjëve.

**Zbatimi i detyrimeve ligjore nga LPRPR-ja:** Të sigurohet aplikimi dhe zbatimi i kornizave ligjore për pjesëmarrjen dhe politikat e të rinjëve, gjë që ndikon në aktivitetet dhe pjesëmarrjen e të rinjëve, me çka do të kontribuohet edhe në krijimin e këshillave, qendrave, strategjive dhe buxhetimit rinor në kuadër të ligjit.

#### **Aspektet ekonomike**

**Kriza energjetike:** Ndikimi i disponueshmërisë dhe çmimeve të energjisave, me një efekt të mundshëm negativ në stabilitetin ekonomik dhe mundësitë për të rinjtë.

**Rritja e pagës mesatare:** Ndikon në aftësinë e disa prej të rinjëve që janë të punësuar ose anëtarët e familjes së tyre për të pasur financa më të qëndrueshme dhe të përfshihen si aktorë në ekonominë lokale.

**Rritja e çmimeve të produkteve bazë:** Ka ndikim në mundësitë e të rinjëve për të siguruar nevojat themelore dhe për të përcaktuar standardet e jetesës. Shpenzimet e rritura të jetesës dëmtojnë stabilitetin financiar e të rinjëve.

**Papunësia dhe mundësitë e pabarabarta:** Mundësitë e pabarabarta për punësim dhe qasjen e të rinjtë me status më të ulët ekonomik, kanë ndikim në gjendjen e përgjithshme ekonomike e të rinjëve dhe mundësitë e tyre për zhvillim dhe karrierë.

#### **Aspektet sociale**

**Rritja e mundshme e numrit të shfrytëzuesve të rinj të ndihmës sociale:** në kushtet e pasigurisë financiare dhe mundësive të pamjaftueshme për punësim, mund të pritet rritje e numrit të të rinjëve që janë shfrytëzues të ndihmës sociale, duke i bërë ata pasivë në vend se të aktivizohen si kërkues të mundësive për punë.

**Masat sociale dhe stimulimi i aktiviteteve:** Ndikon në pjesëmarrjen dhe angazhimin e të rinjëve në fusha të ndryshme të shoqërisë, dhe nxitjen e tyre për vetëpunësim dhe sipërmarrësi.



*Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit midis APRMV-së dhe QPS-së:* Mund të përmirësojë koordinimin dhe efikasitetin e programeve për punësimin e të rinjëve dhe aktiviteteve për mbështetjen e tyre.

### **Aspektet teknologjike**

*Digjitalizimi i shërbimeve publike:* Mundësimi i qasjes më të madhe deri te informacionet dhe shërbimet nga institucionet lokale që janë me rëndësi për të rinjtë, e veçanërisht kur e dimë se sa më të lehta dhe më të arritshme do të ishin këto shërbime për të rinjtë nëse ato do të ishin digjitalizuar.

### **Aspektet ekologjike**

*Gjendja ekologjike në Gostivar në vitet e fundit është përmirësuar, veçanërisht me normalizimin e deponisë në Rusino, por ka ende punë për të bërë në përmirësimin e cilësisë së ajrit, duhet të rriten sipërfaqet e gjelbra në qytet dhe të edukohet shoqëria për problemet ekologjike.*

*Pamundësia për ballafaqim të rregulluar me krizën energjetike:* Ka pasoja potenciale negative mbi gjendjen e përgjithshme ekologjike dhe mjedisin në të cilin jetojnë të rinjtë.

*Rritja e pritshme e vetëdijes së të rinjëve për gjendjen me ndotjen e ajrit dhe kontributi i tyre në zvogëlimin:* Stimulimi i të rinjëve për të qenë të përgjegjshëm ndaj mjedisit dhe natyrës. Vetëdija e rritur te të rinjtë është hapi i parë për një të ardhme më të mirë, duke marrë parasysh se të rinjtë janë ata që do të ndikojnë dhe do të punojnë në përmirësimin e këtyre probleme.

## **1.4. Analiza e palëve të interesuara dhe ndikimi i tyre në strategjinë**

Në përpilimin e strategjisë për mbështetjen dhe zhvillimin e të rinjëve në Komunën e Gostivarit, u identifikuan palë të ndryshme të interesuara që kanë ndikim të rëndësishëm në implementimin dhe suksesin e saj. Këto palë të interesuara janë aktorët kryesorë që formojnë mjedisin dhe kontekstin për aktivitetet dhe programet e orientuara drejt të rinjëve.

### **1. Agjencia për rini dhe sport**

Agjencia për rini dhe sport është kompetente për LPRPR-në. Ajo ka buxhet për të rinjtë dhe organizatat rinore, si dhe buxhet për sport. Ajo gjithashtu ka një rol në menaxhimin e regjistrit të organizatave rinore. Megjithatë, kompetencat kryesore në nivel lokal i kanë komunat përmes formimit të këshillave rinorë dhe qendrave rinore për informim. Ndikimi i këtij institucioni në strategjinë është domethënës meqë përbën bazën ligjore dhe siguron mbështetjen financiare.



## 2. Këshilli Rinor Lokal

Këshillat rinorë lokalë janë përgjegjës për miratimin e vendimeve që prekin të rinjtë në komunë. Ata miratojnë plane dhe programe, mund të propozojnë buxhete lokale dhe të koordinojnë aktivitetet rinore. Gjithashtu, merren me bashkëpunim, mbështetje, përfaqësim dhe lobim për interesat e të rinjëve. Këshillat rinorë lokalë kanë një ndikim të rëndësishëm në strategji, pasi ata janë zbatues të menjëhershëm të aktiviteteve dhe programeve për të rinjtë.

Këshilli rinor lokal në Gostivar është formuar në vitin 2023. Me krijimin e këtij këshilli, pritet të rritet pjesëmarrja e të rinjëve në vendimmarrje dhe strategji në nivel lokal. Gjithashtu, bashkëpunimi midis pushtetit lokal, të rinjëve dhe qendrave rinore është rritur dukshëm. Ka më shumë aktivitete për të rinjtë, dhe të rinjtë kanë vend për të promovuar idetë e tyre.

## 3. Qendra për punë sociale

Qendrat për punë sociale janë ofrues të rëndësishëm të shërbimeve për mbrojtje sociale, si dhe evidencë të personave të rinj në rrezik social. Megjithatë, ata shpesh nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të përfshirë të rinjtë në rrezik social. Rritja e bashkëpunimit me këto qendra është e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të strategjisë, veçanërisht në aspektet që lidhen me integrimin social dhe mbështetjen për të rinjtë në rrezik.

## 4. Organizatat qytetare dhe qendrat rinore

Organizatat e shoqërisë civile që punojnë me të rinjtë dhe qendrat rinore, siç janë Asociacioni i Organizuar Rinor (Organized Youth Association), Qendra Burimore Rinore iCan (Youth Resource Center iCan), Qendra për të rinjtë dhe bashkësinë (Youth and Community Center), Qendra për Ndërmjetësim dhe Edukimin e të Rinjëve (Center for Youth Education and Mediation) dhe të tjera, janë me interes të veçantë sepse janë ofrues të shërbimeve për të rinjtë. Ata implementojnë programe, projekte dhe strategji për të rinjtë, si dhe ofrojnë bashkëpunim, përfaqësim dhe mbështetje për zhvillimin personal dhe social e të rinjëve. Ndikimi i këtyre organizatave është i konsiderueshëm meqë ata janë implementuesit e aktiviteteve në terren dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek të rinjtë në komunë.

Këto palë të interesuara formojnë një rrjet aktorësh që ndikojnë në strategjinë e mbështetjes së të rinjëve në Komunën e Gostivarit. Identifikimi dhe analiza e roleve, interesave dhe dinamikës së tyre është një aspekt kyç në krijimin e strategjisë efektive dhe gjithëpërfshirëse që do t'u përgjigjet nevojave dhe sfidave të të rinjëve në këtë fushë.



## 1.5. Analiza e kapaciteteve (analiza SWOT)

Analiza SWOT (analiza e anëve të forta, të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve) është një vegël të rëndësishme për analizimin e mundësive dhe parakushteve reale për zbatimin e strategjisë rinore. Përfshirja e anëve dhe mundësive të forta si përparësi, si dhe pasqyra e qartë e anëve të dobëta dhe kërcënimeve, do të sigurojë miratimin e masave dhe programeve efikase që do t'i forcojnë kapacitetet dhe mundësitë e të rinjëve në Gostivar dhe do të mundësojnë kushte reale për zbatimin e strategjisë.

### Anët e forta:

*Profesorët e përkushtuar dhe inovativë në shkollat e mesme: Profesorët të cilët janë të angazhuar dhe inovativë mund të krijojnë programe më të mira arsimore dhe të ndikojnë pozitivisht te të rinjtë përmes metodave kreative të nxënies.*

*Stafi i përkushtuar i administratës lokale: Angazhimi i administratës lokale ka ndikim të rëndësishëm në zbatimin e strategjisë rinore, pasi ato mund të krijojnë mjedis pozitiv dhe të lehtësojnë aktivitetet e nevojshme për të rinjtë. Komuna e Gostivarit ka edhe një Nëpunës për të rinjtë, person i cili është shumë i përkushtuar në përmirësimin e gjendjes së të rinjëve në Gostivar.*

*Mbështetja e iniciativave rinore (startup-et, idetë për biznesit, etj.): Mbështetja e iniciativave rinore, të tilla si startup-et dhe idetë për biznes, frymëzon dhe u mundëson të rinjëve të zhvillojnë shkathtësitë dhe kreativitetin e tyre, gjë që është kritike për zhvillimin e tyre. Megjithatë kjo mbështetje është e vogël, ajo më së shpeshti jepet përmes APRMV-së dhe programeve të saj, ndërsa në mënyrë periodike mbështetje e tillë jepet edhe nga qendrat rinore.*

### Anët e dobëta:

*Bashkëpunimi i pamjaftueshëm i organizatave dhe qendrave rinore, shfaqja e pasivitetit midis të rinjëve: Mungesa e komunikimit dhe bashkëpunimit efektiv midis disa organizatave joqeveritare dhe qendrave rinore kufizon ndikimin dhe rezultatet e aktiviteteve rinore. Gjithashtu, pasiviteti i të rinjëve mund të bëjë që një numër i madh i të rinjëve të mungojnë nga programet aktive.*

*Shpërndarja e pamjaftueshme e mjeteve në vetëqeverisjen lokale për aktivitetet rinore: Burimet e kufizuara buxhetore do të vendosin kufizime në zbatimin e strategjisë rinore, të cilat mund të kenë efekt negativ në rezultatet dhe fushëveprimin e programeve për të rinjtë.*

### Mundësitë:

*Fondet për mbështetjen e personave të papunë: Ekzistenca e fondeve që ofrojnë mbështetje për të papunët paraqet një mundësi për përfshirjen dhe përmirësimin e stabilitetit ekonomik e të rinjëve.*





*Marrëveshjet e arritura të bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare:* Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mund të sjellë resurse, njohuri dhe përvoja plotësuese për promovimin e programeve dhe projekteve rinore.

*Mundësitë e financimit për organizatat dhe qendrat rinore:* Ekzistojnë burime të ndryshme financimi për organizatat dhe qendrat rinore, të cilat mund të forcojnë kapacitetet dhe ndikimin e tyre.

### **Kërcënimet:**

*Reduktimi i mjeteve për të rinjtë në buxhetin e komunës si pasojë e krizës ekonomike në vend:* Kriza ekonomike mund të çojë në rritjen e konkurrencës për mjetet buxhetore dhe uljen e mbështetjes financiare për aktivitetet rinore.

*Përparimi i pamjaftueshëm drejt qëllimit të rritjes së vetëdijes për rritjen e informimit:* Angazhimi i dobët i aktorëve kompetentë mund të shkaktojë vonesë në rritjen e vetëdijes dhe pjesëmarrjes së të rinjëve dhe të ndikojë negativisht në implementimin e strategjisë.

*Shpërngulja e të rinjëve nga komuna:* Largimi i të rinjëve nga komuna është kërcënim i madh për Komunën e Gostivarit, dhe mund të rezultojë në ulje të popullsisë së të rinjëve dhe mungesë të fuqisë së kualifikuar punëtore në të ardhmen, e kjo mund të rrisë sfidat në realizimin e strategjisë.



## 2. KORNIZA STRATEGJIKE

### QËLLIMI KRYESOR I STRATEGJISË:

**Pjesëmarrja proaktive e të rinjëve në krijimin e politikave, vendimmarrje, rrjetëzim dhe inkluzion në Komunën e Gostivarit, me qëllim të sigurimit të kushteve për jetë cilësore, punë, rritje dhe zhvillim personal dhe informim dhe bashkëpunim strategjik.**

#### FUSHA 1 – PJESËMARRJA E TË RINJËVE

**Qëllimi strategjik 1.1: Mundësi të përmirësuara për zhvillim personal, aktivizëm rinor dhe vullnetarizëm të të rinjëve në Komunën e Gostivarit**

Rezultatet:	Treguesit
<b>1.1.1 Pjesëmarrje e rritur e të rinjëve në proceset vendimmarrëse në proceset arsimore dhe organizimin e tyre</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përqindja e të rinjëve që marrin pjesë në këshilla dhe komisione në shkollat e tyre ose institucionet lokale.</li> <li>Numri i takimeve për komunikim të rregullt mes të rinjëve dhe institucioneve lokale.</li> <li>Numri i punëtorive dhe trajnimeve të organizuara për të rinjtë në fushën e pjesëmarrjes</li> </ul>
<b>1.1.2 Kanale të vendosura për komunikim të rregullt dhe informim të ndërsjellë për përparimin ekzistues në fushën e pjesëmarrjes së të rinjëve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i të rinjëve që kanë deklaruar se janë të informuar rregullisht për mundësitë për të marrë pjesë në aktivitetet në dispozicion.</li> <li>Numri i mediave sociale dhe platformave onlajn që sigurojnë informacione për aktivitetet e të rinjëve.</li> </ul>
<b>1.1.3 Aktivizmi i promovuar rinor dhe sukseset personale e të rinjëve nga Komuna e Gostivarit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i ngjarjeve të organizuara nga komuna për promovimin e aktivizmit rinor dhe sukseseve.</li> <li>Numri i pjesëmarrësve në ngjarjet për promovimin e aktivizmit dhe sukseseve rinore.</li> </ul>

#### Masat sipas Qëllimit 1.1:

- Bashkëpunimi me shkollat përmes takimeve të rregullta koordinuese në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrje më e madhe e të rinjëve në proceset arsimore
- Analiza e praktikave ekzistuese pozitive e të rinjëve dhe për të rinjtë
- Mekanizmi i vendosur i menaxhimit për vendimmarrje dhe koordinim në zbatimin e aktiviteteve me institucionet, shoqatat për të rinjtë, organizatat rinore të interesuara, etj.

**Qëllimi Strategjik 1.2: Të rinjtë dallohen si faktorë relevantë dhe pjesëmarrës proaktivë në proceset kryesore shoqërore**

Rezultatet:	Treguesit
<b>1.2.1 Të rinjtë e shquar me bursa në fusha të ndryshme të veprimit të tyre</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i të rinjëve të cilët janë pjesëmarrës të dalluar që kanë bursa në fusha të ndryshme.</li> <li>Numri i të rinjëve të shquar të promovuar në mediat dhe bashkësitë.</li> </ul>



### 1.2.2 Pjesëmarrjes e përmirësuar e të rinjëve përmes buxhetimit pjesëmarrës nga të rinjtë për të rinjtë në bashkëpunim me Komunën e Gostivarit

- Numri i propozimeve iniciativave të parashtrura për buxhetimin pjesëmarrës nga të rinjtë.
- Përqindja e propozimeve të pranuarra për buxhetim pjesëmarrës të paraqitura nga të rinjtë.

#### Masat sipas Qëllimit 1.2:

- Organizimi i ngjarjeve për edukimin e të rinjëve për pjesëmarrjen e të rinjëve
- Sigurimi i mundësive nga komuna dhe biznesi lokal për bursa për të rinjtë
- Promovimi i mundësive për bursa për të rinjtë
- Edukimi i të rinjëve për arsimimin financiar dhe buxhetimin pjesëmarrës
- Përpilimi i propozimeve buxhetore për komunën dhe propozim iniciativa

### Qëllimi strategjik 1.3: Këshilli rinor lokal përfaqëson me sukses nevojat e të rinjëve para Këshillit Komunal, institucioneve lokale dhe faktorëve të tjerë

Rezultatet:	Treguesit
<b>1.3.1 KRL kontribuon dhe stimulon pjesëmarrjen e të rinjëve në Komunën e Gostivarit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i ngjarjeve të organizuara nga Këshilli Rinor Lokal për të stimuluar pjesëmarrjen e të rinjëve.</li> <li>• Numri i pjesëmarrësve në ngjarje për të stimuluar pjesëmarrjen e të rinjëve.</li> </ul>
<b>1.3.2 Pozicioni i përmirësuar i të të rinjëve në proceset e bashkëpunimit, vendimmarrjes dhe veprimit me institucionet lokale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i konsultimeve ndërmjet Këshillit Rinor Lokal dhe institucioneve lokale.</li> <li>• Numri i iniciativave nga Këshilli Rinor Lokal drejtuar institucioneve lokale.</li> </ul>
<b>1.3.3 Mundësi të përmirësuara për jetë cilësore për të rinjtë në komunë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i programeve dhe projekteve të implementuara që kanë për qëllim përmirësimin e standardit jetësir për të rinjtë.</li> </ul>
<b>1.3.4 Shkathtësi të përmirësuara dhe punësueshmëria e të rinjëve përmes implementimit të programeve aktive të mentorimit nga Këshilli Rinor Lokal</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i programeve të mentorimit të iniciuara nga Këshilli Rinor Lokal.</li> <li>• Numri i të rinjëve që marrin pjesë në programet e mentorimit</li> <li>• Numri i të rinjëve që e vlerësojnë përvojën si të suksesshme.</li> </ul>

#### Masat sipas Qëllimit 1.3:

- Organizimi i ngjarjeve promovionale nga KRL
- Aktivitete për krijimin e programeve të përbashkëta ndërmjet të rinjëve dhe institucioneve në të cilat të rinjtë marrin pjesë në mënyrë aktive
- Përgatitja dhe zbatimi i programeve të mentorimit në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe bizneset
- Përpilimi i programit për forcimin e sigurisë ekonomike dhe punësimit të të rinjtë



## FUSHA 2 – INFORMIMI I TË RINJËVE

### Qëllimi strategjik 2.1: Rrjeti i vendosur lokal për informimin e unifikuar dhe sistemor e të rinjëve

Rezultatet:	Treguesit
<b>2.1.1 Disponueshmëri e përmirësuar e informacionit të saktë dhe aktual për tema të ndryshme me interes për të rinjtë</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Përqindja e të rinjëve që shprehen të kënaqur me disponueshmërinë e informacionit për tema të ndryshme.</li><li>• Numri i sesioneve informative ose trajnimeve të organizuara për të rinjtë nga rrjeti për informim.</li></ul>
<b>2.1.2 Edukim i përmirësuar themelor, primar për të rinjtë me sistem për mbështetje dhe programe për mentorim përmes rrjetit për informimin e të rinjëve</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Numri i shkollave të përfshira në sistemin për mbështetje dhe programin për mentorim.</li><li>• Përqindja e të rinjëve që marrin pjesë në programet për mentorim përmes rrjetit për informim dhe i vlerësojnë ato si të dobishme.</li></ul>
<b>2.1.3 Ndikimi dhe fushëveprimi i përmirësuar i iniciativave rinore përmes rrjetit të vendosur</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Numri i iniciativave rinore që arrijnë publikun e synuar përmes rrjetit të vendosur.</li><li>• Numri i partneriteteve me organizata ose institucione që janë vendosur për të mbështetur iniciativat rinore.</li></ul>

#### Masat sipas Qëllimit 2.1:

- Rrjetëzimi i organizatave dhe institucioneve lokale në një rrjet të vetëm për informimin lokal e të rinjëve
- Qasja deri te materialet edukative për të rinjtë
- Zhvillimi i vetëdijes dhe shkathtësive të menduarit kritik
- Mundësitë që të rinjtë të marrin pjesë në diskutime
- Përfshirja e të rinjëve në bashkësinë e tyre
- Mbajtja e trajnimeve për aftësimin e personave për mentorim

### Qëllimi strategjik 2.2: Rol i forcuar i qendrave rinore dhe nëpunësve rinorë në komunë si pikë informative për të rinjtë

Rezultatet:	Treguesit
<b>2.2.1 Shkathtësi dhe njohuri të përmirësuara e të rinjëve për përdorimin e teknologjisë dhe veglave digjitale</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Përqindja e të rinjëve që deklarojnë se kanë përparim në zhvillimin e shkathtësive dhe njohurive të tyre teknologjike.</li><li>• Numri i trajnimeve dhe punëtorive të organizuara për të rinjtë në mënyrë që t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre teknologjike.</li></ul>
